



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 29 korrik 2010
Nr. ref.: RK 58/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 53/09

AVDI KASTRATI

kundër

Vendimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit
Ac. Nr. 540, të 8 qershorit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare,

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Avdi Kastrati nga Prizreni, Kosovë.

Vendimi i sfiduar

2. Vendimi i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, Ac. Nr. 540, i 8 qershorit 2009.

Çështja e lëndës

3. Parashtruesi i kërkesës pohon që Gjykata e Qarkut e Prizrenit, me vendimin e vet Ac. Nr. 540, të 8 qershorit 2009, e ka shkelur Kushtetutën e Kosovës pasi ka dështuar: (1) të garantojë mbrojtje të barabartë të të drejtave të tij në procedurën gjyqësore (Neni 31.1 i

Kushtetutës); (2) të ofrojë shqyrtim të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet e tij (Neni 31.2 i Kushtetutës); dhe (3) të ofrojë mbrojtje gjyqësore dhe mjete efektive ligjore për të drejtën e tij për pronë të garantuar me Kushtetutë (Neni 54 i Kushtetutës).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 20 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, (në tekstin e mëtejme Ligji), dhe Neni 54(b) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme Rregullorja).

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës

5. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese më 12 tetor 2009.
6. Kryetari e caktoi Gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar Raportues. Kryetari gjithashtu e caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova, kryesuese, Enver Hasani dhe Ivan Čukalović. Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit Raportues në seancë të mbyllur më 16 korrik 2010, dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që kërkesën ta hidhte poshtë si të papranueshme.
7. Gjyqtari Altay Suroy kishte shërbyer më herët si avokat për njërën nga palët e përfshira në këtë procedurë kontestimore. Si rrjedhojë, Gjyqtari Altay Suroy kërkoi të përjashtohet nga shqyrtimi i kësaj çështjeje dhe kjo u pranua me vendim të Gjykatës.

Faktet

8. Driton Xharra lidhi marrëveshje me parashtruesin e kërkesës më 24 nëntor 1997 për ta vënë në hipotekë pronën e paluajtshme të z. Xharra që gjendet në rrugën Adem Jashari në Prizren, në shumë prej 300,000 DM (marka gjermane), 225,000 DM për kryegjë dhe 75,000 DM për interes, për një vit, që duhej të paguhej më 1 dhjetor 1998, për t'i siguruar detyrimet e borxhit të mikut të tij Fatmir Qollaku.
9. Parashtruesi i kërkesës përpiloi një kontratë të shitblerjes, në të cilën theksonte se z. Xharra ia kishte shitur pronën parashtruesit të kërkesës më 26 nëntor 1997 për 300,000 DM, shumë të cilën parashtruesi e kishte paguar në tërësi dhe kishte kërkuar që z. Xharra t'ia bartte të drejtën, pronësinë dhe posedimin e pronës në emër të parashtruesit deri më 10 dhjetor 1999.
10. Kontrata u ekzekutua nën besimin se kishte të bënte me marrëveshjen për hua, të diskutuar më parë, që vuri hipotekë në pronën e tij.
11. Në ngjarjet që pasuan, z. Xharra nuk ishte në gjendje t'ia paguante parashtruesit të kërkesës borxhin prej 300,000 DM deri në afatin e përcaktuar në marrëveshje.
12. Parashtruesi i kërkesës lidhi një marrëveshje të re me z. Xharra më 24 qershor 2000 lidhur me borxhin fillestar, me ç'rast z. Xharra obligohej t'ia paguante parashtruesit 330,000 DM deri më 1 dhjetor 2000, ose z. Xharra do ta humbte posedimin, pronësinë dhe të drejtën e pronës së lënë peng.
13. Z. Xharra lidhi marrëveshje të re me parashtruesin e kërkesës më 30 mars 2002, e cila kërkonte që kunati i z. Xharra, Islam Kastrati, t'ia paguante 230,000 DM parashtruesit të kërkesës dhe z. Qollaku do ta merrte pjesën e mbetur të borxhit prej 100,000 DM. Me pagesën prej 230,000 DM, z. Xharra duhej të lirohej nga të gjitha detyrimet e veta ndaj parashtruesit të kërkesës.

14. Siç kërkohej me marrëveshjen e re, Islam Kastrati ia pagoi, në emër të z. Xharra, 230,000 DM parashtuesit të kërkesës përmes të birit të vet, Agron Kastrati, më 31 mars 2002. Megjithatë, parashtuesi i kërkesës refuzoi ta kthente dokumentacionin përkatës lidhur me pronën e kontestuar për ta liruar z. Xharra nga detyrimet e veta, duke pohuar që borxhi prej 100,000 DM kishte mbetur pa u paguar.
15. Në bazë në kontratës së shitblerjes, të 15 shkurtit 1999, të regjistruar në Gjykatën Komunale të Prizrenit nën Leg. Nr. 496/99, parashtuesi i kërkesës e barti të drejtën e pronës së kontestuar në emër të tij në vitin 2007.
16. Z. Xharra ngriti padi kundër parashtuesit të kërkesës për pronën e kontestuar në Gjykatën Komunale të Prizrenit, e cila u dëgjua më 29 prill 2008.
17. Gjykata Komunale e Prizrenit (Gjykata Komunale) në vendimin C. Nr. 670/07, nxori një aktgjykim me të cilin “në tërësi e miratoi padinë e” z. Xharra dhe e shpalli të “pavlefshme” kontratën e shitblerjes, të 15 shkurtit 1999, për pronën e kontestuar ndërmjet z. Xharra, si shitës, dhe parashtuesit të kërkesës, si blerës, të regjistruar në Gjykatën Komunale të Prizrenit nën Leg. Nr. 496/99. Parashtuesi u urdhërua t’i mbulonte të gjitha shpenzimet procedurale, shpenzimet ligjore për përpilimin e padisë dhe shpenzimet për masa të përkohshme.
18. Gjykata komunale vendosi ndër të tjera që:
 - (1) kontrata e shitblerjes së pronës së paluajtshme Leg. Nr. 496/99, e regjistruar në Gjykatën Komunale të Prizrenit, nuk ishte kontratë për shitblerje, por ishte një kontratë huaje për sigurimin e borxhit;
 - (2) kontrata e shitblerjes ishte fiktive dhe nuk kishte të bënte me shitblerje, por me sigurimin e borxhit;
 - (3) z. Xharra u mashtrua pasi besoi që kontrata ishte hipotekë për sigurimin e borxhit, e jo kontratë e shitblerjes për pronën e tij, dhe
 - (4) të gjitha provat e administruara kishin të bënin me borxhin dhe kthimin e tij, e jo me shitjen e pronës.
19. Parashtuesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër vendimit të gjykatës komunale pranë Gjykatës së Qarkut, e cila më 8 qershor 2009 vendosi ta refuzonte ankesën e parashtuesit. Gjykatë e Qarkut konstatoi se faktet në dokumente ishin konfirmuar dhe se e drejta materiale ishte zbatuar pa shkelje themelore të procedurës civile apo të rregulloreve të gjykatës në vendimin e gjykatës komunale. Për më tepër, siç pohoi parashtuesi, prona e kontestuar nuk ishte blerë, por ishte vënë në hipotekë për ta siguruar borxhin. Gjykata e Qarkut konsideroi që z. Xharra e kishte kthyer borxhin.
20. Parashtuesi i kërkesës paraqiti kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese më 12 tetor 2009 për anulimin e vendimit të Gjykatës së Qarkut dhe kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën komunale.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Parashtuesi i kërkesës pohon që Neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), paragrafi 1 dhe 2, dhe Neni 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) i Kushtetutës së Kosovës janë bazë për kërkesën e tij.
22. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës thotë:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

23. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk duhet të veprojë si gjykatë e apelit kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat më të ulëta. Gjykatat më të ulëta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës (GC), nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
24. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (shih Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson si Neni 31 apo 54 e mbështesin kërkesën e tij, siç kërkohet me Nenin 113.7 të Kushtetutës dhe Nenin 48 të Ligjit.
25. Parashtruesi i kërkesës pohon që të drejtat e tij ishin shkelur për shkak të konstatimit të gabuar të fakteve nga gjykatat më të ulëta dhe zbatimit të gabuar të ligjit, pa referenca specifike lidhur me atë se si këto vendime i shkelën të drejtat e tij kushtetuese.
26. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i ishin ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e vet dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit që mendonte se ishte i gabuar, para Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Gjykatës Supreme. Pas ekzaminimit të procedurave si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen që procedurat përkatëse ishin të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
27. Si përfundim, kjo kërkesë nuk i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri. Ai ka dështuar të theksojë dhe mbështesë me dëshmi të drejtat dhe liritë kushtetuese që gjoja janë shkelur nga vendimi i sfiduar.
28. Prandaj, rezulton që kjo kërkesë është qartazi e pabazë dhe duhet të hidhet poshtë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata kushtetuese, në seancën e datës 29 korrik 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Sekretaria do t'i njoftojë palët me këtë vendim dhe do ta publikojë atë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Almiro Rodrigues, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.